

VENDIM
Nr.457, datë 16.4.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR AKADEMINË E SHKENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e vitit 2008, zërit “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 dhjetë milionë) lekësh për të përballuar shpenzimet për botimin e “Fjalorit Enciklopedik Shqiptar”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha